



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.515/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektivit Politik Kosova Demokratik Turk Partisi KDTP, me seli në Prizren, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

HEDHEN të palejuara ankesat A.nr.515/2025, A.nr.516/2025, A.nr.517/2025, A.nr.518/2025, A.nr.519/2025, A.nr.520/2025, A.nr.521/2025 dhe A.nr.568/2025 të datës 10.02.2025, dhe ankesat A.nr.570/2025, A.nr.571/2025, A.nr.572/2025, A.nr.573/2025, A.nr.574/2025, A.nr.575/2025, A.nr.577/2025, A.nr.578/2025, A.nr.579/2025, A.nr.580/2025, A.nr.581/2025, Anr.582/2025, A.nr.583/2025, A.nr.584/2025 dhe A.nr.585/2025, të datës 11.02.2025 të parashtruara nga Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi KDTP, me seli në Prizren, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: A.nr.515/2025, A.nr.516/2025, A.nr.517/2025, A.nr.518/2025, A.nr.519/2025, A.nr.520/2025, A.nr.521/2025 dhe A.nr.568/2025, më datë 10.02.2025, në të cilat pretendon se ka pasur parregullësi në vendvotimet SH.F.M.U “Ibrahim Banushi” Shalë me numrin 1306, SH.F.M.U “Fehmi Agani” Gjakovë me numrin 0208, SH.F.M.U “Hamëz Thaçi” Xërxë me numrin 1614, SH.F.M.U “Ismail Qemali” Saradran me numrin 0602, SH.F.M.U “Trepça” Banjë e Pejës me numrin 0602, SH.F.M.U “Tefik Çanga” Ferizaj me numrin 2501, SH.M.L “Zenel Hajdini” Ferizaj me numrin 2508 dhe Shkolla-Dajkoc me

numrin 1014. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar rinumërimin e votave në këto vendvotime, dhe ankesat A.nr.570/2025, A.nr.571/2025, A.nr.572/2025, A.nr.573/2025, A.nr.574/2025, A.nr.575/2025, A.nr.577/2025, A.nr.578/2025, A.nr.579/2025, A.nr.580/2025, A.nr.581/2025, A.nr.582/2025, A.nr.583/2025, A.nr.584/2025 dhe A.nr.585/2025, të datës 11.02.2025, në të cilat pretendohet se ka pasur parregullësi në vendvotimet SH.F.M.U “Nazim Kokollari” Prizren me numër 2016/2, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” Prizren me numër 2007/5, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” Mitrovica e Jugut me numër 1103, SH.F.M.U “Bedri Gjina” Mitrovicë e Jugut me numër 1107, SH.F.M.U “Ismail Qemali-Saradran me numër 0617, SH.M.L “Zenel Hajdini” Ferizaj me numër 2508/05, SH.F.M.U “Abdyl Frashëri” Prizren numër 2002/7, Shkolla Fadil Hisari Prizren me numër 2006/5, Shkolla Dajkoc 1014/1, Shkolla Ismail Qemali Mitrovicë e Jugut 1104, Shkolla SH.M.L.T “Arkitekt Sinani” Mitrovicë e Jugut 1101, SH.F.M.U “Andon Zako Çajupi” Mitrovicë e Jugut me numër 1106, Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit Lagjja e Boshnjakëve me numër 3801, SH.M.L Mjekësisë Mitrovicë e Veriut me numër 3806, SH.F.M.U “Sveti Sava” Mitrovicë e Veriut me numër 3804. Po ashtu parashtruesi i ankesës ka kërkuar rinumërimin e votave në këto vendvotime.

Në përgjigje në ankesat A.nr.515/2025, A.nr.516/2025, A.nr.517/2025, A.nr.518/2025, A.nr.519/2025, A.nr.520/2025, A.nr.521/2025 dhe A.nr.568/2025 të datës 10.02.2025, KQZ ka theksuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), bazuar në Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës neni 102 paragrafi 5 ka bërë përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bënë publike përmes platformës elektronike me datën 10.02.2025. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të ndryshohen, korrektohen dhe plotësohen, nga Qendra Komunale të Numërimit (QKN) dhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), e cila mundëson në evitimin e çdo gabimi teknik pas publikimit të rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve nga KQZ-ja. Më tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se pala ankuese nuk e precizuar gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e mospërputhjes me ndonjë dokument siç janë vëzhguesit e akredituar, Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike dhe pretendimet e palës ankuese nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe nuk janë të mbështetura nga ndonjë provë e qartë dhe bindëse, për më tepër, ankesa në fjalë konsiderohet e palejuar, pasi që nuk bie në kategorinë e vendimeve të KQZ-së që mund të ankimohen në PZAP.

Në përgjigje në ankesat A.nr.570/2025, A.nr.571/2025, A.nr.572/2025, A.nr.573/2025, A.nr.574/2025, A.nr.575/2025, A.nr.577/2025, A.nr.578/2025, A.nr.579/2025, A.nr.580/2025, A.nr.581/2025, A.nr.582/2025, A.nr.583/2025, A.nr.584/2025 dhe A.nr.585/2025, KQZ, ka theksuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), bazuar në Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës neni 102 paragrafi 5 ka bërë përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bënë publike përmes platformës elektronike me datën 10.02.2025. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të ndryshohen, korrektohen dhe plotësohen, nga Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) dhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), e cila mundëson në evitimin e çdo gabimi teknik pas publikimit të rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve nga KQZ-ja. Më tutje në përgjigje në ankesë pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen

faktike, nuk janë specifikuar arsyet e mospërputhjes me ndonjë dokument, siç janë, raportet e vëzhguesve të akredituar nga KQZ, Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike, libri i votimit, deklaratat e KVV etj.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.515/2025, A.nr.516/2025, A.nr.517/2025, A.nr.518/2025, A.nr.519/2025, A.nr.520/2025, A.nr.521/2025 dhe A.nr.568/2025 të datës 10.02.2025, dhe ankesat A.nr.570/2025, A.nr.571/2025, A.nr.572/2025, A.nr.573/2025, A.nr.574/2025, A.nr.575/2025, A.nr.577/2025, A.nr.578/2025, A.nr.579/2025, A.nr.580/2025, Anr.581/2025, A.nr.582/2025, A.nr.583/2025, A.nr.584/2025 dhe A.nr.585/2025, të datës 11.02.2025 janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.515/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti politik Subjekti Politik Kosova Demokratik Turk Partisi KDTP, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

Paneli vlerëson se pretendimi i palëve ankuese edhe pse i referohen parregullsisve në ditën e votimit, për shkak se përmes këtyre ankesave atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor - faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim ”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesave të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr. 515/2025 më datën 12.02.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.